



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 44/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Ferizaj, për shkak të fillimit të fushatës elektorale para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetarë të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 20.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa si e palejuar.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 17.04.2012, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, parashtruar ndaj subjektit politik AAK, konkretisht ndaj kandidatit për kryetar të Komunës së Ferizajt Naim Ferati, me te cilën pretendohet se nga data 14 Prill ka publikuar në faqen zyrtare të rrjetit social të Facebook, që ka filluar fushatën e tij elektorale para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore, ku me ç'rast sipas parashtruesit të ankesës veprimet e tij bien në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet në Kosovë si dhe me *Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët*, pasi që periudha zyrtare e fushatës për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, është data nga 23 deri 27 Prill 2012. Më tej parashtruesi i ankesës thekson se në faqen zyrtare të këtij rrjeti social është paraqitur edhe numri 21 i kandidatit.

Të bashkangjitur me ankesën si provë materiale parashtruesi i ankesës ka printuar faqen zyrtare të kandidatit Naim Ferati, nga rrjeti social Facebook.

KREU -V- i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP)

Kodi i mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët

Neni 33 i LZP-së, Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike dhe Rregulla Zgjedhore nr.11/2009 *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësit e tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

KREU -VII- i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP)

Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike

Neni 44 i LZP-së, Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike dhe Rregulla Zgjedhore nr.13/2009 *Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e palejuar

Sepse duke u bazuar në dispozitat lartcekura ligjore PZAP-i konstatoi se pretendimet e theksuara në ankesë, nuk janë bërë gjatë periudhës së caktuar për fushatë zgjedhore, prandaj nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara të subjekteve politike, ngase në LZP-së, e as me Rregulla Zgjedhore nuk është paraparë ndonjë dispozitë ligjore që ndalojnë fillimin e fushatës elektorale para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore.

Në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 44/2012 më datën 20.04.2012.

**Kryesuesi i panelit
Muhamet Rexha**

